



Në bazë të Nenit 8, Par. 6, të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, vendimit Nr. 01 104/02-8350/24 i datës 04 prill 2024 për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të OJQ-ve për financim të projekteve/programeve të paraqitura në thirrjen publike për mbështetje financiare për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në promovimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të publikuar më 30.04.2024 me numer 09-104/02-10114/24, dhe në bazë të Rregullorws Nr.04/2017, Komisioni në takimin e parë të mbajtur më datë 27.05.2024 miraton:

## RREGULLAT E PUNËS

Të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për financim publik të projekteve/programeve sipas thirrjes publike për mbështetje financiare për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në promovimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

### Neni 1

#### Qëllimi i miratimit të rregullave

1. Rregullat e punës të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financim të projekteve/programeve sipas thirrjes publike do të rregullojë mënyrën e kryerjes së detyrave, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Komisionit, vendimmarrjen dhe çështje të tjera në kuadër të kompetencave të komisionit.
2. Komisioni do të punojë duke u bazuar në Rregullat në fuqi, në veqanti në bazë të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

### Neni 2

#### Kompetencat e komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të vlerësoj çdo aplikim nëse i plotëson ose jo kushtet e përgjithshme procedurale të përcaktuara me thirrjen publike dhe rreguloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Komisioni do të përgatis një raport për të gjitha aplikacionet e shqyrtaura nga komisioni duke listuar të gjitha aplikacionet dhe duke treguar nëse i plotësojnë ose jo kushtet kushtet e thirrjes publike.
3. Në fazën e dytë të vlerësimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e përbajtjes të të gjitha aplikimeve në kuadër të thirrjes publike të cilat i plotësojnë kriteret formale për vlerësim përbajtësor.
4. Komisioni vendos për ndarjen e detyrave brenda komisionit, dhe përcakton nëse secili nga anëtarët do të vlerësojnë secilin aplikacion apo do të bëhet ndarja e përgjegjësive.
5. Edhe në rastet kur brenda komisionit ndahen detyrat, përgjegjësia e komisionit dhe vendimmarrja është kolektive.
6. Komisioni do të sigurojë që secili nga anëtarët të ketë ndarje dhe ngarkesë proporcionale me detyra në kuadër të komisionit.
7. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e komisionit paraqet ndonjë konflikt interesit, atëherë komisioni duhet të shqyrtoj rastin e tillë dhe ti kërkojë udhëheqësit të institucionit zëvendësimin e tij. Në këto raste, deri në zëvendësimin e anëtarit në konflikt interesit, anëtarri rezervë do ta zëvendësoj atë.
8. Tek vlerësimi i përbajtjes së aplikacioneve, komisioni ka për detyrë të bëjë kalkulimin e pikëve përfundimtare për secilin nga aplikacionet e që do të llogaritet duke marrë përbazë pikët e secilit nga anëtarët e komisionit të mbledhura dhe të pjestuara për të pér numrin e anëtarëve të komisionit për të nxjerrë pikët mesatare që do të marrë secili aplikacion.
9. Bazuar në vlerësimet e secilit projekt/program, komisioni për vlerësimin e aplikacioneve do të bëjë listën

preleminare të projekteve/programeve të cilat do të financohen përmes fondeve publike.

10. Komisioni është përgjegjës për të bërë listën përfundimtare të përsituesve të projekteve të cilat do të mbështeten përmes fondeve publike dhe të njëjtën do e përcjellë për aprovim përfundimtar tek udhëheqësi/zurtai më i lartë administrativ përgjegjës për fondet publike në kuadër të institucionit.

### **Neni 3** **Detyrat e anëtarëve të komisionit**

1. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë aplikacionet në aspektin procedural si në vijim:
  - 1.1. Të hapin çdo aplikim të paraqitur në kuadër të thirrjes publike dhe të bëjnë regjistrimin e përkatës të aplikacionit, duke përfshirë edhe vendosjen e numrave referues.
  - 1.2. Të analizojnë të gjithë dokumentacionin e paraqitur.
  - 1.3. Përcaktojnë nëse aplikimet i kanë përbushur kushtet e konkursit, duke përfshirë edhe përdorimin e formave të standardizuara dhe plotësimin e tyre nga ana e aplikuesve.
  - 1.4. Të përcaktojnë nëse aplikantët i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara përmes thirrjes publike.
  - 1.5. Nëse është e nevojshme të kërkojnë nga aplikantët për të siguruar informacion/dokumentacion shtesë por që nuk ndikon në përbajtjen e aplikacionit, si dhe kontrollimin dhe verifikimin e këtij informacioni/dokumentacioni shtesë.
  - 1.6. Të hartojnë dhe të nënshkruajnë procesverbalin e takimit duke përcaktuar nëse secili prej aplikimeve në mënyrë individuale i plotëson ose jo kushtet e thirrjes publike, mbi bazën e të cilit pastaj Institucioni përkatës do të përgatisë një njoftim me shkrim për aplikantët.
2. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë përbajtjen e aplikacioneve si në vijim:
  - 2.1. Të informohet me tekstin e thirrjes publike dhe të nënshkruajnë një deklaratë të paanësisë dhe konfidencialitetit.
  - 2.2. Të shqyrtojë dhe vlerësojë përbajtjen e projekteve dhe programeve të OJQ-ve aplikuese të cilat i kanë plotësuar kriteret procedurale. Vlerësimi duhet të bëhet sipas pyetjeve dhe formave të parapara me rregullativën juridike në fuqi.
  - 2.3. Të bëjë vlerësim të paanshëm, objektiv dhe pa ndikim nga subjekte tjera, duke shpjeguar me shkrim vlerësimin e tij, dhe duke iu referuar në shpjegimet e tij dokumentacionit të OJQ-së aplikuese, madje edhe duke cituar atë, dhe duke treguar pse pikërisht ka bërë atë poentim(vlerësim).
  - 2.4. Të vlerësoj koston e projektit për të formuar buxhetin e nevojshëm për implementimin e tij.
  - 2.5. Të identifikojë dhe vlerësoj përparësitë dhe mangësitë e çdo aplikacioni të vlerësuar.
  - 2.6. Të rekomandoj sigurimin e dokumentacionit shtesë nëse e sheh të nevojshme.

### **Neni 4** **Përbërja e komisionit dhe detyrat e anëtarëve**

1. Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve sipas thirrjes publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në promovimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka 6 anëtarë duke përfshirë kryesuesin e komisionit dhe anëtarin rezervë.
2. Kryesuesi e koordinon punën e Komisionit, duke përfshir edhe koordinimin e qëndrimeve për përgatitjen e raportit përfundimtar të Komisionit vlerësues.
3. Në rast të dorëheqjes së ndonjërit nga anëtarët e komisionit vlerësues, vendimin për aprovimin e dorëheqjes së tij e merr zyrtari kryesor administrativ i cili ka themeluar komisionin. Deri në aprovimin formal të dorëheqjes, anëtarët janë të detyruar të marrin pjesë në punën e rregullt të komisionit, përvëç rasteve të konfliktit të interesit.
4. Në rast të dorëheqjes së ndonjërit nga anëtarët e komisionit, kryesuesi do të ftoj anëtarin rezervë për të marrë pjesë në vlerësim.

**Neni 5**  
**Shmangia e konfliktit të interesit dhe mbajtja e konfidencialitetit**

- Çdo anëtar i Komisionit vlerësues është i detyruar që në fillim të nënshkruajnë një deklaratë të paanësisë dhe konfidencialitetit. Me nënshkrimin e Deklaratës, anëtarët e Komisionit konfirmojnë se detyrat e tyre në komision do trajtohen në mirëbesim, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me parimin e shmangies së konfliktit të interesave. Po ashtu, ata pranojnë se do të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha aplikacionet, duke i vlerësuar në përputhje me rregullat më fuqi.
- Secili anëtarë i komisionit që ka informacion se ndonjëri nga anëtarët mund të ketë konflikt interes, duhet që ta informojë komisionin menjëherë.
- Anëtarët e komisionit vlerësues gjatë dhe pas përfundimit të punës së komisionit nuk kanë të drejtë të nxjerrin informacion në publik apo të informojnë ndonjërin prej aplikantëve mbi përmbajtjen e diskutimeve dhe vendimeve të marra përkicazi me aplikimet individuale, dhe nuk guxojnë të jepin asnjë lloj informacioni i cili është i karakterit të brendshëm.
- Emrat e anëtarëve të komisionit do të bëhen publik vetëm kur të publikohen rezultatet e thirrjes.

**Neni 6**  
**Mbështetja teknike për komisionin vlerësues**


Për krahja administrative dhe teknike për të gjitha aktivitetet e komisionit që ndërlidhen me thirrjen publike duhet të sigurohet nga institucioni/njësia që ka hapur thirrjen publike.


**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**


Rregullat e punës së komisionit vlerësues janë miratuar në takimin/seancën e mbajtur


më :27.05.2024.


**Kryesuesi i komisionit**

  
Emri Mbiemri, nënshkrimi

  
Emri Mbiemri, nënshkrimi

  
Emri Mbiemri, nënshkrimi

  
Emri Mbiemri, nënshkrimi

  
Emri Mbiemri, nënshkrimi  
(anëtar rezervë)